



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES-MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-SKUPCHINA MALISHEVO



PRANUAR ME
ACCEPTED ON
DATE

13/03/2024

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

01/305

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Datë: 13.03.2024

01/_____

Në bazë të nenit 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik. Në bazë të Udhëzimit Administrativ Për Kujdesin Parësor Shëndetësor Nr. 04/2020, nenit 15. Në bazë Ligjit Për Pagat në Sektorin Publik Nr. 08/L-196 shtojcës 9 numër 13, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Malishevës me datën 13.03.2024, shpallë:

KONKURSE PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS.

I. Titulli i vendit të punës: Mjek/e i/ e Përgjithshëm/e në QKMF, QMF, AMF-“Dr: Shpëtim Robaj”- Malishevë.

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale-DSHMS
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave	4 (Kater) pozita
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i QKMF-së
Grada/ Koeficienti	H-10, 7.4
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese	Gjashtë (6) muaj

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mjek/e i/e Përgjithshëm

- Ofron shërbime me standardë të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi.
- Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për pacientin nën mbikëqyrjen e mjekut familjar.
- Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikëqyrjen e Mjekut Familjar.
- Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë
- Kujdesi për personat në nevojë
- Mbanë kujdestari gjatë vikendit dhe natën.
- Mbanë orarin prej 40 orë ne javë sipas Ligjit Për Zyrtarët Publik dhe Ligjit të Punës.
- Edukimi shëndetësor etj.
- Udhëheq me ditarin e punës ditore të vizitave si dhe Regjistrimin e të dhënave në SISH.

Dokumentet e nevojshme:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë drejtimi i Përgjithshëm (kopjen e noterizuar)
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuar nga MASHT:
- Formulari i aplikimit i plotësuar:
- Rezymeja personale (CV):
- Licencën e punës me afat, (kopjen e noterizuar):
- Certifikatën e lindjes: (Originalin)
- Certifikatën që nuk është nën hetime ose i dënuar në Gjykatë (Originalin).
- Letërnjoftimin e fotokopjuar:
- Certifikatën e mjekut për punë (Pas përzgjedhjes nga Komisioni):
- Përvoja e punës (e dëshirueshme).

II. Titulli i vendit të punës: Infermier/e i Përgjithshëm/e në QKMF, QMF, AMF- Dr. “ Shpëtim Robaj” – Malishevë.

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik,
Numri i Pozitave	5 (pesë) Pozita
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i QKMF-së
Grada/ Koeficienti	H-17 -5.4
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të pa caktuar
Periudha provuese	6 (gjashtë) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë për Infermier i Përgjithshëm.

- Pranon dhe triazhon pacientët në QKMF
- Përgatitë pacientët për vizitë mjekësore
- Kryen punë administrative shëndetësore
- Përgjigjet për participimin e pacientëve
- Kryen sipas nevojës punët e kartotekës, intervencës, patronazhit, terrenit dhe edukimit
- Bënë aplikimin e terapisë si dhe përcjelljen e shenjave vitale gjatë kohës së transportit të pacientëve,
- Bënë bartjen e pacientëve prej shërbimit deri në ambulant dhe anasjelltas
- Sipas urdhrit të shefit të mjekësisë familjare kryen edhe punë tjera
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit dhe Shefit të Sektorit të Mjekësisë Familjare.
- Udhëheq me ditarin e punës ditore të vizitave si dhe Regjistrimin e të dhënave në SISH.

Dokumentet e nevojshme për Infermier të Përgjithshëm.

- Diplomën e Fakultetit të Infermierisë - Bachelor ose diplomën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë (kopjen e noterizuar)
- Licencën e punës me afat (kopjen e noterizuar).
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, diploma duhet njihet nga MPB.
- Formulari i aplikimit i plotësuar
- Rezymeja personale (CV)
- Certifikatën e lindjes, (origjinali).
- Certifikatën që nuk është nënë hetime ose i dënuar në Gjykatë (origjinali)
- Letërnjoftimin të fotokopjuar .
- Certifikatën e mjekut për punë (pas përzgjedhjes nga komisioni
- Përvoja e punës (e dëshirueshme)

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/ aplikanteve:

- Testi me shkrim
- Intervistë

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike, aplikacionet dorëzohen nga data 13.03.2024 deri më 12.04.2024, ora (16:00), në Zyrën për pritjen e palëve Komuna Malishevë.

Paraqitja e kërkesave:

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këtë vend të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në Zyrën për pritjen e palëve KK- Malishevë, si dhe mund të shkarkohen nga web-faqja zyrtare e Komunës së Malishevës, dhe të plotësuara dorëzohen në zyrën e pranimit.

Konkursi është i shpallur në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> , si dhe ne web faqen e Komunës së Malishevës dhe tabelën e shpalljeve në Komunën e Malishevës dhe QKMF-së.

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

-Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Udhëheqësi i Njësise për menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Gani Bajtjaraj, jur.dipl.

